



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 12, Datë 29.01.2024

MBI

**REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRINI BULQIZE” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 11, pika 2, 13, pika 2, gërma “a” dhe 14, pika 2 e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 130/4 prot., datë 22.01.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2416 prot., datë 17.11.2023, ka paraqitur aplikimin e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 355, datë 01.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 02.12.2023 dhe 04.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2417/5 prot., datë 07.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit, duke evidentuar dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Me shkresat me nr. 2417/6 prot. dhe nr. 2416/3 datë 11.12.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet e gjithashtu të sqarohet një pjesë e këtij dokumentacioni me shoqërinë.
- Në këto rrethana, me shkresën nr. 2417/8 prot., datë 19.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e saj.
- Nisur nga nevoja për të pasur kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit shtesë dhe/ose shkëmbimin e një korrespondence të mëtejshme me shoqërinë, bordi i ERE-s me

vendimin nr. 382, datë 28.12.2023 vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë. Shoqëria u njoftua mbi këtë vendim, me shkresën nr. 28 prot., datë 04.01.2024.

- Pas depozitimit të dokumentacionit shtesë të aplikimit dhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 17.01.2024, shoqëria me e-mailin e datës 18.01.2024, rezulton se ka depozituar informacion/dokumentacion për aplikimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, por nuk ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues në kuadër të aplikimit për licencim në tregtimin e energjisë elektrike e po ashtu as ndonjë argument mbi pamundësinë e plotësimit të këtij dokumentacioni.
- Nga analizimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar brenda afatit dokumentacionin e kërkuar nga nenin 9, pika 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në nenin 11, pika 2 dhe nenin 13, pika 2, gërma “a” të Rregullores për përcaktohet se: *Nëse aplikuesi nuk paraqet informacionin shtesë brenda afatit, formës dhe përmbajtjes së caktuar, kjo do të përbëjë kusht për refuzimin e aplikimit.* dhe po ashtu në nenin 13, pika 2 përcaktohet se: *Në marrjen e vendimit për licencimin ose refuzimin e licencimit të një shoqërie aplikuese, Bordi i ERE-s merr në konsideratë kriteret e mëposhtme:*
 - a. *plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur në përputhje me sa përcakton kjo rregullore ose/dhe kërkesat për informacion shtesë të ERE-s.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI